

# URIME PËRVJETORI I 75-të!

Kontribuar nga Murat  
Saturday, 13 June 2009

Profesor Ullmar! U R I M E P Ë R V J E T O R I I 75-të!  
Me rastin e 75 vjetorit të lindjes së mikut të madh të shqiptarëve

Albanologut &ndash; prof. ULLMAR QVICK

&ndash; Një biografi dhe veprimtari e shkurtër -

Nga Prof Mr Ismet M. Hasani  
E- mail: ekspertih@hotmail.com

Ullmar Qvick ka lindur më 13. Qershor 1934 në Eskilstuna - Suedi. Ishte fëmija i parë në familje të varfër. Babi i tij ishte punëtor, por me interesa intelektuale për artet, politiken, natyrën dhe gjendjen në botë. Nëna ishte shtylla e familjes, babi ishte disi në botën e vetë; Me sakrificat e familjes, Ullmarit iu lejua të vazhdonet studimet në gjimnaz dhe në shkollën pedagogjike. Ai u interesua për çështjet ndërkombëtare për gjuhë të huaja, dhe ky interesim u forcua përmes dëgjimit të radiostacioneve të botës, me një aparat të vogël me valë të shkurtra.

Ullmari u bë specialist i radios ndërkombëtare dhe ruan edhe sot shumë letra nga radiostacionet e ndryshme të botës. Në këtë mënyrë ai mori kontakt edhe me Radioshqiptarë, jo vetëm Radio-Tiranën, por edhe me radiostacionet e Shkodrës dhe Kukësit, të cilat degjoheshin me vështirësi në Suedinë e largët. Ai ruan edhe sot libra, fotografi etj. si dëshmi për këto kontakte. Çështje e vërteta, letra e parë nga Radio-Tirana i kishte ardhur Ullmarit në fund të vitit 1948, kur ky ishte vetëm 14 vjeç!

Pas mabrimit të studimeve të larta, Ullmari filloi të punonte si arsimtar nëpër fashtra të ndryshme e më pas në Eskilstuna, ku në Shkollën për të ritur ishte si arsimtar edhe për fëmijët shqiptarë.

Ullmari filloi të meret me përkthime. Dhe ka shumë vepra të përkthyer, veqanërisht vepra të gjuhës shqipe të përkthyer në gjuhën suedishte. Edhe pas pensionimit nga puna ai vazhdoi punën me përkthime. Ka botuar nga seri librash të përkthyer nga vet ai, shumë vepra të autorëve shqiptarë dhe ka bashkëpunuar në përpilimin e disa veprave gjuhësore: tre fjalorë të shqipes dhe suedishtes dhe një gramatikë suedisht-shqip. Në vitin 2004 u botua libri i tij me titull " Mera Hjaltemod än vete" që në shqipe përkthehet " Më shumë heroizma se grurë", që benë fjalë për shqiptarët gjatë shekullit XX (20). Ka përpiluar edhe një fjalor shqip-suedisht, në bashkëpunim me mikun e tij Lars-Erik Morin. Për angazhimin e tij për popullin shqiptarë, Ullmari mori emertimin "Shqiptar Nderi" . Ky albanolog i shquar ka mar shumë dekorata nga Zyra e Kosovës në Suedi. Poashtu është i dekoruar edhe nga Shoqata Bamirëse "Nëna Tereze" - dega në Suedi. Ullmari mori çmimin e parë në konkursin e poezisë shqipe, që u organizuar në Malmö, në vitin 2004.

Kjo që unë shënova është vetëm si një "insert" nga jeta dhe veprimtaria e bujshme e albanologut skandinav Ullmar Qvick, i cili bëri aq shumë për popullin shqiptar, veqanërisht këtu në Skandinavi e me theks të posaqëm për shqiptarët në Suedi. Për ta pasqyruar në terësi jetën dhe veprimtarinë e albanologut &ndash; profesor Ullmar Qvick nevojitet një kohë shumë e gjatë dhe duhet të shkruhen jo vetëm libra, por edhe romane. Pasurimin e këtyre librave do ta bëjnë dhe do të japin edhe vet shqiptarët në shtetet Skandinave, veqmas ata në Suedi, ata që e njohin dhe patën kontakte të drejtpërdrejta me te, ata të cilët ruajnë kujtime përmes letrave, fotografive, fjalëve që ua foli profesor Ullmari, ata të cilët ia panë lotët që i pikën nga sytë e Ullmarit përshkak të vet shqiptarëve këtu në Suedi, ata të cilët duhet të shpalosin kujtimet e tyre të para disa viteve dhe të shprehin në vepër së paku një pjesë të asaj që profesori &ndash; albanologu Ullmar Qvick bëri për ta dhe familjet e tyre. Vetëm në këtë mënyrë ndoshta mund të dalim "hakut" këtij njeriu kaq të dashur për shqiptarë. Ne, si shqiptarë, profesorin e respektuar &ndash; albanologun Ullmar Qvick e kemi edhe më të afërt, e kemi vertetë mik, e kemi edhe dhëndërr, ngase vet Ullmari, është i martuar me një femër shqiptare nga Kosova.

Unë personalisht pata fatin tim jetësor që ta njoh këtë njeri: Nga kureshtja edhe zemra &ndash; u nxit që ta kërkoj. Duke ju falënderuar mikut tim Shems Rukocit nga Norvegjia, erdha gjer ta adresa, konkretisht te e-maili i internetit dhe arrita që të kam korrespondencë përmes letrave me profesorin e nderuar Ullmar Qvick. Ato letra i ruaj me një fanatizëm të veçantë dhe posa të vijë koha, e në pajtim me profesorin Ullmar, edhe do të dergoj në botim, sepse janë një urtësi e vertetë.

Vetëm në këtë mënyrë, por edhe në mënyra tjera, mund të falënderohemi, ta respektojmë, ta përshëndesim atë dhe vepërën e tij ngase "Përshëndetja është gjest afrimi nder njerëz, andaj duhet respektuar dhe pranuar në mënyrën më të mirë!" Dhe këtij shkrimi tim do të pikën, pasi të shkruaj disa urtësi, të cilat ia kushtoj të respektuarit albanologut, profesorit dhe mikut të madh të shqiptarëve - Ullmar Qvick, por edhe popullit tim.

A. "Jeta e njeriut i gjason anijës kozmike, kur prej fillimit çdo gjë shënohet, e pastaj ai shkrim lexohet. Mendja e njeriut i gjason parashutës, e cila për derisa rri e mbyllur nuk shërben për asgjë, por pasi të hapet ta shpëton jetën. Jeta e njeriut pa shtet është e vetmuar, e mjerë, e ndyer, brutal dhe e shkurtër!" (i.m.h)

Prej lulës kërkohet aroma, prej njeriut kërkohet mirësjellëja.  
 Rrënjët e njerëzimit janë: mëshira dhe përuhtësia.  
 Të dua lëmë lavdinë e përjetëshme të vdekurve- të gjallëve dashurinë e përjetëshme.  
 Nga një jetë e keqe kurrë nuk mund të vijë dishka e mirë!  
 Shpirti i njeriut i përngjanë ujit, fati i njeriut i përngjanë erës.  
 Tri gjëra janë të vështira: të dëgjosh, të shohësh dhe të heshtësh!  
 Duhet të jetosh që të mësosh!  
 I mjerë është ai që jeton me atë që nuk e dashuron.  
 Më lehtë është të njohësh sot dhjetë shtete, se sa një njeri &hellip;  
 Të dua jo vetëm për atë që je, por edhe për atë që jam me ty.  
 Gjatë jetës, lotët që shpejt derdhën, shpejt edhe terën.  
 Jeta është e shkurtër, e verteta rron gjatë dhe arrinë larg.  
 Jeta s'vlenë aspak kur mungon liria.  
 Njerëzit e mëdhenjë fillojnë të jetojnë edhe pas vdekjes.  
 Ah! Sikur të ishte e mundur të blejë një vit ose bile së paku një muaj rinie?  
 Sa më e poshtër të është jeta, aq më shumë iu dhimbset njerëzve.  
 Në jetë është madhështi të bësh dikujt mirë, por edhe më madhështi është ta pranosh të mirën nga tjetri.  
 Jeta është shumë e shkurtër për të duruar edhe barrën e gabimeve të tjerëve.  
 Çdo njeri e paguan jetën e vet për të jetuar.  
 Cili jam? Nga kam ardhë? Ç'është duhet të bëjë? Ç'është duhet të besoj? Ç'është duhet të shpresoj? &ndash; Kjo është filozofia.  
 Edhe pak për prof Ullmar:  
 Më 20 Nëntor 2004 u mbajt Festivali i IV i Poezisë dhe Muzikës Shqiptare në qytetin Malmö i organizuar nga rrethi i shoqatave Shqiptare në rajonin Skones (Suedi). Në këtë eveniment morën pjesë një numër mjaft i madh krijuesish. Me çmimin e parë u vlerësuan krijimet e albanologut të njohur Ullmar Qvick.

## NGUJIMI

Turgut Pasha e vuri në flakë Malësinë e Mbishkodrës  
 Gjyshi u dogj i gjallë gjatë shtetrrethimit  
 Gjyshja me gjashtë fëmijë mori malet  
 U strehuan dhe shpëtuan jetën  
 Gjoni u rrit jetim.  
 Kur erdhën partizanët Gjoni u mbrojt në kullë  
 Filloi ngujimi shtatëditësh  
 Gjoni mori një plumb në gjoks  
 Nëna dhe tetë fëmijë të uritur  
 U dërguan për internim në Tepelenë  
 Deda, më i vogli, u kthye në fshatin e farefisit  
 një ditë të zymtë prilli të vitit nëntëdhjetenjë  
 Sylejman Shehu, oficer sigurimi  
 të ardhur me urdhër nga jug  
 e kishte uzurpuar kullën  
 Deda priti veç pak,  
 deri sa u prish kolektivi bujqësor  
 dhe krisi pushka si dikur për tokë  
 U vra Sylejmani, Deda e mori në dorë kullën  
 filloi të punonte tokat, bleu tri lopa  
 dhe buzëqeshi për herë të parë në jetë...  
 Shtatë vite më vonë erdhi vëllau i Sylejmanit  
 me hakmarrje piramidale në duar  
 Filloi ngujimi pesëvitësh  
 Dy djemtë e Dedës ikën jashtë  
 për të bërë punë të zezë nëltali  
 Deda u dogj i gjallë një ditë të zymtë pranvere  
 pasi dështuan të gjitha përpjekjet e pajtimit  
 Ngjarja nuk u sqarua nga policia me sy të verbër  
 Kulla e zezë, kulla e vdekjes, u braktis  
 por bari u rrit në rrezet e diellit.  
 Mbi fytyrat e djemve të Dedës  
 bie hija e kanunit të Lekës  
 mbeturinat e traditës çnjerëzore  
 Ku fryn era e akullit të hakmarrjes  
 nxihen lulet, helmohen zemrat  
 Vetëm njerëz të lirë mund të mposhtin ngujimin

Sëmundja e traditës kërkon shërim të shpejtë  
 kërkon frymë njerëzore, dritë edhe dituri!  
 Se hija e kanunit është hija e vdekjes  
 ndërsa fëmijët duan jetë dhe lumturi...

#### BURRË DHE GRUA

Lëndinë e bukur ku pushoj  
 në bar të butë dhe erëmirë  
 është trupi yt plot hijeshi  
 më mbush me ëndje dhe dëshirë  
 Në çast u dogj kjo flaka ime  
 dhe sytë e tu porsi burime  
 pohuan qejf edhe gëzime  
 si mrekulli, si ëndërrime  
 O, këto çaste përqaftimi  
 të nxehtë porsi një fllad jugor  
 me puls të jetës më rrethojnë  
 dhe ndjej atë përjetësim rinor....  
 E dashur, ti je motër e fshehtësisë  
 e dhimbjes edhe gazit zanafillë  
 Me adhurim të shkruaj këto fjalë  
 se vetëm ti parajsën më ke sjellë

#### LULET E KOSOVËS

Të bukura janë bozhuret dhe lulëkuqet  
 prapë dihet se gjaku kërkon gjak  
 dhe mjaft lule gjaku çelen në Kosovë  
 Në oborr të Fakultetit rriten bresat  
 pak të ashpër në shtat, ndërsa lulet  
 me ngjyrë të kaltër,  
 veç pak të kuqe brenda!  
 Në prag të Fakultetit ngjyra e besës  
 ngjyra e shpresës!  
 Dëgjoj të qeshurat e studentëve...  
 Bresat më shikojnë me sy të kaltër  
 Po mendoj për të ardhmen,  
 për besën dhe shpresën  
 në jetën e rinisë kosovare...

(&hellip; kjo është një pjesë e vockël e poezive në gjuhën shqipe nga Ullmar Qvick, përndryshi prof Ullmar ka shumë e shumë poezi, krijime e botime, jo vetëm në gjuhën shqipe e suedishte të cilat i ka studjuar, por edhe në shumë gjuhë tjera&hellip; )

Dhe për në fund, prof Ullmar, MIKU YNË I VLEFSHËM, EDHE NJË HERË: URIME PËRVJETORI I 75-të, të urojmë shëndet të plotë, harmoni në familje, mbi JU të mbizotëroi QETËSIA SHPIRTËRORE!

G Ë Z U A R!

Me respekt e dashuri të sinqertë miqësore,

miku i juaj i vërtetë,  
 Ismet M. Hasani, Hässleholm (Suedi)